



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorní Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.736/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevc i anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelet e subjekteve politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) me seli në Prizren, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) me seli në Ferizaj si dhe Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), të paraqitura kundër vendimit me numër 860-2021 i datës 04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, që ka të bëjë me shpalljen e rezultatit përfundimtar i publikuar me datë 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e Panelit, të mbajtur më datë 07.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN pjesërisht të bazuara apelet Anr.736/2021 i datës 05.03.2021, e paraqitura nga subjektet politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) me seli në Prizren, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) me seli në Ferizaj dhe apeli Anr.769/2021 i datës 05.03.2021, i paraqitur nga Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), anulohen fletëvotimet që i përkasin subjektit politik Romani Iniciativa, në Vendvotimet (VV), si në vijim:

a. Për Komunën e Leposaviqit:

- 10 fletëvotime në VV 1201B/01R,
- 26 fletëvotime në VV 1201B/02R,
- 31 fletëvotime në VV 1201B/03D,
- 10 fletëvotime në VV 1201X/01R,
- 24 fletëvotime në VV 1202B/01R,
- 7 fletëvotime në VV 1202B/02R,
- 21 fletëvotime në VV 1202B/03D,
- 27 fletëvotime në VV 1205B/01R,
- 33 fletëvotime në VV 1205B/02R,
- 45 fletëvotime në VV 1205B/03D

b. Për Komunën e Novobërdës:

- 16 fletëvotime në VV 1403D/01D,
- 39 fletëvotime në VV 1404D/01D,
- 26 fletëvotime në VV 1406D/01D,
- 18 fletëvotime në VV 1410D/01D,
- 15 fletëvotime në VV 1412D/01R,
- 9 fletëvotime në VV 1412D/02D,
- 30 fletëvotime në VV 1413D/01D,
- 31 fletëvotime në VV 1414D/01D,
- 5 fletëvotime në VV 1415D/03D,

- 9 fletëvotime në VV 1417D,01D,
- 11 fletëvotime në VV 1418D/01D,

c. Për Komunën e Ranilluk:

- 12 fletëvotime në VV 3501D/01R,
- 17 fletëvotime në VV 3501D/02D,
- 27 fletëvotime në VV 3502D/02D,
- 18 fletëvotime në VV 3504D/01R,
- 38 fletëvotime në VV 3504D/02D,
- 14 fletëvotime në VV 3505D/01D,
- 26 fletëvotime në VV 3506D/01D,
- 7 fletëvotime në VV 3507D/01D,

d. Për Komunën e Parteshit:

- 12 fletëvotime në VV 3601D/01R,

- 9 fletëvotime në VV 3601D/02D,
- 16 fletëvotime në VV 3602D/01R,
- 4 fletëvotime në VV 3602D/02D,

- 16 fletëvotime në VV 3603D/01R,
- 11 fletëvotime në VV 3603D/02R,
- 20 fletëvotime në VV 3603D/03D,

e. Për Komunën e Killokotit:

- 30 fletëvotime në VV 3701D/01R,
- 27 fletëvotime në VV 3701D/02D,
- 46 fletëvotime në VV 3702D/01D,
- 28 fletëvotime në VV 3703D/01R dhe
- 16 fletëvotime në VV 3703D/02D.

II. URDHËROHET Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që fletëvotimet e anuluar nëpër Vendvotimet e theksuara, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, t'i largoj nga rezultati përfundimtar i Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, i publikuar me vendimin nr. 860-2021 i datës 04.03.2021.

III. REFUZOHEN pjesërisht të pabazuara apelet Anr.736/2021 i datës 05.03.2021, e paraqitur nga subjektet politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) me seli në Prizren, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) me seli në Ferizaj dhe apeli Anr.769/2021 i datës 05.03.2021, në pjesën që ka kërkuar që të anulohen fletëvotimet në raport me subjektin politik Romani Iniciativa, në Vendvotimet: 1001D/01R, 1001X/03R, 1010D/01D, 1013D/01D, 1015D/01R, 1015D/02D, 1016D/01D, 1017D/01D, 1301E/01R, 1301X/01R, 1301X/02R, 1301X/03R, 1301X/04D, 1303E/01R, 1303E/02R, 1303E/03D, 1311E/01D, 1315E/01D, 1319E/01D, 1320E/01D, 1329E/02D, 3401E/01R, 3401E/02R, 3401E/03R, 3401E/04R, 3401E/05R, 3401E/06R, 3401R/07R, 3401E/08D, 3402E/01R, 3402E/02R, 3402E/03D, 3403E/01D, 3404E/01R, 3404E/02D, 3405E/01R, 3405E/02R, 3405E/03D, 3406E/01R, 3406E/02D, 3407E/01D, 3408E/01R, 3408E/02D, 3409E/01R, 3410E/01D, 3411E/01D, 3412E/01D, 3414E/01R, 3414E/02D dhe 3415E/01D.

A r s y e t i m

Me datën 05.03.2021, PZAP-i ka pranuar apelet Anr.736/2021 dhe Anr.769/2021, të paraqitura nga subjektet politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), me seli në Ferizaj si dhe Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, kundër vendimit të KQZ-së, 860-2021 të dt. 04.03.2021, ne te cilën pretendohet se ka pasur shkelje serioze të LZP ne

zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, lidhur me publikimin e rezultateve përfundimtare, përkatësisht ndaj numërimit të votave të paraqitura për subjektin politik Romani Iniciativa. Sipas të dhënave zyrtare ky subjekt politik ka marrë 4049 vota. Parashtruesit e apeleve konkludojnë se votat e fituara nga subjekti politik Romani Iniciativa, janë të orkestruara dhe të koordinuara mes të këtij subjekti politik dhe të subjektit politik Lista Serbe, si dhe me subjektet e tjera politike me qëllim të përforcimit të kundërligjshëm të pozitës së tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Sipas parashtruesve të apelit me ndërhyrjen e subjektit politik Lista Serbe në vullnetin e lirë të votuesve në këto zgjedhje të këtij viti kanë ndryshuar rrënjësisht votat e fituara nga subjekti politik i sapo formuar Romani Iniciativa duke tejkaluar në masë të madhe partitë tradicionale në Kosovë. Andaj, bazuar në të dhënat zyrtare të deritanishme të KQZ-së, subjekti politik Romani Iniciativa, në këto zgjedhje mori 4049 vota, pjesa dërmuese e këtyre votave ishin në këto komuna si: Kamenicë 283 vota, ndërsa sipas regjistrimit të popullsisë të ASK-së dhe raportit të OSCE-së ka 240 banorë, në Leposaviq 245 vota, ndërsa 64 banorë, në Lipjan 281 vota, ndërsa 342 banorë, në Novobërdë 216 vota, ndërsa 63 banorë, në Graçanicë 1773 vota, ndërsa 745 banorë, në Ranilluk 200 vota, ndërsa 0 banorë, në Partesh 89 vota, ndërsa 0 banorë, në Kllokot 147 vota, ndërsa 9 banorë, në Mitrovicën Veriore 198 vota, ndërsa 40 banorë. Parashtruesit e apeleve si dëshmi kanë paraqitur një tabelë ku shihet se si janë ndarë votat në zgjedhjet e viti 2021 për komunat :

Kamenicë, vendvotimi 1015D/01R ku subjekti politik RI ka marrë 44 vota, subjekti politik LS ka marrë 98 vota ndërkaq LS në vitin 2019 nga ky vendvotim ka marrë 168 vota, në vendvotimin 1015D/02, subjekti politik RI ka marrë 47 vota, subjekti politik LS ka marrë 105 vota, ndërkaq LS në vitin 2019 nga ky vendvotim ka marrë 193 vota, në vendvotimin 1016D/01D subjekti politik RI ka marrë 39 vota, subjekti politik LS ka marrë 94 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 177 vota, në vendvotimin 1017D/01D subjekti politik RI ka marrë 3 vota, subjekti politik LS ka marrë 169 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 189 vota. Në komunën e Lipjanit, në vendvotimin 1301X/01R subjekti politik RI ka marrë 11 vota, subjekti politik LS ka marrë 12 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 28 vota, në vendvotimin 1301X/04D subjekti politik RI ka marrë 5 vota, subjekti politik LS ka marrë 5 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 21 vota, në vendvotimin 1311E/01D subjekti politik RI ka marrë 71 vota, subjekti politik LS ka marrë 125 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 110 vota, në vendvotimin 1319E/01D subjekti politik RI ka marrë 48 vota, subjekti politik LS ka marrë 31 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 106 vota. Në komunën e Novobërdës në vendvotimin 1404D/01D subjekti politik RI ka marrë 39 vota, subjekti politik LS ka marrë 131 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 178 vota, në vendvotimin 1406D/01D subjekti politik RI ka marrë 26 vota, subjekti politik LS ka marrë 47 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 95 vota, në vendvotimin 1413D/01D subjekti politik RI ka marrë 30 vota, subjekti politik LS ka marrë 151 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 205 vota, në vendvotimin 1414D/01D subjekti politik RI ka marrë 31 vota, subjekti politik LS ka marrë 123 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 172 vota. Në komunën e Graçanicës në vendvotimin 3401E/02R subjekti politik RI ka marrë 90 vota, subjekti politik LS ka marrë 144 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 313 vota, në vendvotimin 3401E/03R subjekti politik RI ka marrë 98 vota, subjekti politik LS ka marrë 150 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 296 vota, në vendvotimin

3401E/05R subjekti politik RI ka marrë 79 vota, subjekti politik LS ka marrë 171 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 334 vota, në vendvotimin 3401E/06R subjekti politik RI ka marrë 104 vota, subjekti politik LS ka marrë 153 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 319 vota. Në komunën e Ranillugës, në vendvotimin 3502D/01R subjekti politik RI ka marrë 40 vota, subjekti politik LS ka marrë 269 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 428 vota, në vendvotimin 3502D/02D subjekti politik RI ka marrë 27 vota, subjekti politik LS ka marrë 237 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 348 vota, në vendvotimin 3504D/02D subjekti politik RI ka marrë 38 vota, subjekti politik LS ka marrë 169 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 251 vota, në vendvotimin 3506D/01D subjekti politik RI ka marrë 26 vota, subjekti politik LS ka marrë 197 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 250 vota. Në komunën e Parteshit, në vendvotimin 3601D/01R subjekti politik RI ka marrë 12 vota, subjekti politik LS ka marrë 227 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 198 vota, në vendvotimin 3602D/01R subjekti politik RI ka marrë 16 vota, subjekti politik LS ka marrë 229 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 354 vota, në vendvotimin 3603D/01R subjekti politik RI ka marrë 16 vota, subjekti politik LS ka marrë 282 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 305 vota, në vendvotimin 3603D/03D subjekti politik RI ka marrë 20 vota, subjekti politik LS ka marrë 227 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 297 vota. Në komunën e Kllokotit, në vendvotimin 3701D/01R subjekti politik RI ka marrë 30 vota, subjekti politik LS ka marrë 117 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 223 vota, në vendvotimin 3701D/02D subjekti politik RI ka marrë 27 vota, subjekti politik LS ka marrë 139 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 237 vota, në vendvotimin 3702D/01D subjekti politik RI ka marrë 46 vota, subjekti politik LS ka marrë 82 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 188 vota, në vendvotimin 3703D/01R subjekti politik RI ka marrë 28 vota, subjekti politik LS ka marrë 211 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 324 vota. Në komunën e Mitrovicës Veriore në vendvotimin 3805X/01R subjekti politik RI ka marrë 36 vota, subjekti politik LS ka marrë 491 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 282 vota, në vendvotimin 3805X/02R subjekti politik RI ka marrë 28 vota, subjekti politik LS ka marrë 477 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 491 vota, në vendvotimin 3805X/06D subjekti politik RI ka marrë 19 vota, subjekti politik LS ka marrë 393 vota, ndërkaq LS nga ky vendvotim në vitin 2019 ka marrë 509 vota. Me ane të kësaj ankese kërkohet nga PZAP-i të ndërmarr veprimet e nevojshme dhe të rishikohen të gjitha vendvotimet ku ka ardhur deri tek manipulimet me trupin votues në komunat e banuara me shumicë serbe. Po ashtu kërkohet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme kundër individëve dhe partive politike të përfshira në shkeljen e dispozitave ligjore dhe kushtetuese, pasi që Republika e Kosovës dhe të gjithë autoritetet e saj përfshirë edhe PZAP-in e kanë për obligim kushtetues konform nenit 58(4) të garantojnë pjesëmarrjen efektive të të gjitha komuniteteve në jetën publike dhe vendimmarrje. Një obligim i tillë për Kosovën derivon edhe nga neni 15 i Konventës Kornize të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, mekanizëm kyç në tërë këto strukture pa efikasitetin e të cilit nuk kanë kuptim mekanizmat e tjerë të pjesëmarrjes së komuniteteve jo shumicë në Kuvendin e Kosovës, ku 20 ulëse nga gjithsejtë 120 janë të garantuara për komunitete jo shumicë sipas nenin 64 par 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat elaborohen edhe nga neni 111 i LZP-se. Këto vende janë të garantuara për

komunitetet përkatëse dhe supozohet se vota vjen pikërisht nga komuniteti i njëjtë me atë që deklarohet se përfaqëson komunitetin që konkurren për deputet. Andaj një deformim i tillë i këtij mekanizmi përfaqësues mohon çfarëdo përfaqësimi efektiv të komunitetit rom në Kosovë, dhe është në kundërshtim me nenin 58 (4) dhe 64 (2) të Kushtetutës së Kosovës. Parashtruesi e këtyre apeleve kërkon nga PZAP që me qëllim të përfaqësimit efektiv të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe ruajtjes së qëllimit të hartuesve dhe frymës së kushtetutës të garantuar ulëset për komunitete jo shumicë që jetojnë në Kosovë, parashtruesit e këtyre apeleve kërkojnë nga PZAP që ta bëjë anulimin e të gjitha votave të subjektit politik Romani Iniciativa të marra në të gjitha vendvotimet e cekura si më poshtë, të cilat janë vendbanime me shumicë serbe: 1001D/01R, 1001X/03R, 1001D/01D, 1013D/01D, 1015D/01R, 1015D/02D, 1016D/01D, 1017D/01D, 1201B/01R, 1201B/02R, 1201B/03D, 1201X/01R, 1202B/01R, 1202B/02R, 1202B/03D, 1205B/01R, 1205B/02R, 1205B/03D, 1301E/01R, 1301X/01R, 1301X/02R, 1301X/03R, 1301X/04D, 1303E/01R, 1303E/02R, 1303E/03D, 1311E/01D, 1315E/01D, 1319E/01D, 1320E/01D, 1329E/02D, 1403D/01D, 1404D/01D, 1406D/01D, 1410D/01D, 1412D/01R, 1412D/02D, 1413D/01D, 1414D/01D, 1415D/03D, 1417D/01D, 1418D/01D, 3401E/01R, 3401E/02R, 3401E/03R, 3401E/04R, 3401E/05R, 3401E/06R, 3401R/07R, 3401E/08D, 3402E/01R, 3402E/02R, 3402E/03D, 3403E/01D, 3404E/01R, 3404E/02D, 3405E/01R, 3405E/02R, 3405E/03D, 3406E/01R, 3406E/02D, 3407E/01D, 3408E/01R, 3408E/02D, 3409E/01R, 3410E/01D, 3411E/01D, 3412E/01D, 3414E/01R, 3414E/02D, 3415E/01D, 3501D/01R, 3501D/02D, 3502D/02D, 3504D/01R, 3504D/02D, 3505D/01D, 3506D/01D, 3507D/01D, 3601D/01R, 3601D/02D, 3602D/01R, 3602D/02D, 3603D/01R, 3603D/02R, 3603D/03D, 3701D/01R, 3701D/02D, 3702D/01D, 3703D/01R, 3703D/02D, 3803B/01R, 3805B/02R, 3805B/03R, 3805B/04R, 3805B/06R, 3805B/07R, 3805B/08R, 3805B/09R, 3805B/10D, 380X/01R, 3805X/02R, 3805X/04R, 3805X/05R, 3805X/06D, 3806B/01D.

Me përgjigje në kërkesë të KQZ-ja, përveç tjerash ka theksuar se në mandatin e saj nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese duke kërkuar nga paneli që ankesën ta refuzoi si të pabazuar.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, i ka bashkuar apelet e lartcekura dhe të njëjtat i trajton si një apel, të evidentuar me Anr.656/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për çka të gjitha i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore, provave që gjinden në shkresat e lëndës, materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apelet janë pjesërisht të bazuara.

Paneli, me datat 06 dhe 7 mars 2021, sipas detyrës zyrtare, ka zhvilluar hetime për të vërtetuar gjendjen faktike të rastit konkret dhe erdhi në përfundim se apelet janë pjesërisht të bazuara, për arsye se:

Subjekti politik Romani Iniciativa, ka marrë vota më shumë se që ka pas votues potencial të komunitetit Rom, për të votuar në ditën e votimit të datës 14 shkurt 2021, në VV:

1201B/01R, 1201B/02R, 1201B/03D, 1201X/01R, 1202B/01R, 1202B/02R, 1202B/03D, 1205B/01R, 1205B/02R, 1205B/03D, 1403D/01D, 1404D/01D, 1406D/01D, 1410D/01D, 1412D/01R, 412D/02D, 1413D/01D, 1414D/01D, 1415D/03, 1404D/01D, 1417D,01D, 1418D/01D, 3501D/01R, 3501D/02D, 3504D/01R, 3504D/02D, 3505D/01D, 3506D/01D, 3507D/01D, 3601D/01R, 3601D/02D, 3602D/01R, 3602D/02D, 3603D/01R, 3603D/02R, 3603D/03D, 3701D/01R, 3701D/02D, 3702D/01D, 3703D/01R dhe 3703D/02D, bazuar në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës i vitit 2011, Raportit të OSBE-së të vitit 2018, dhe bazuar në Listën Përfundimtar të Votimit të verifikuar emër për emër secilin votues potencial, në vendvotimet e lartcekura.

Votat e marra në vendvotimet e lartcekura nga Romani Iniciativa, janë në disproporcion me numrin e banorëve, të komunitetit rom, e të cilat paraqesin vota të pa vlefshme, për faktin se është standard jodemokratik, që me votat e votuesve të një komunitetit tjetër të sigurohet e drejta e përfaqësimit të një komuniteti tjetër dhe si të tilla nuk paraqesin lidhja objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar.

Për herë të parë në zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës, subjekte të caktuara si në këtë rast Rumani Iniciativa, ka marrë shumicën e votave nga komuniteti serb, gjë që në këtë rast, paraqet devijim të vullnetit të votuesit të komunitetit rom, e krejt kjo në thelb paraqet minimin e integritetit të procesit.

Sipas vlerësimit të Panelit, minimi i procesit zgjedhor, përmes votimit në këtë mënyrë të orkestruar për subjekte të caktuara për të zgjedhur përfaqësuesit e komunitetit rom, përveç devijimit të vullnetit të votuesit, kjo në vetvete cenon demokracinë e brendshme zgjedhore, eliminon garën në mes të subjekteve për vendet e garantuara dhe krejt kjo është në kundërshtim me nenin 111 paragrafi 1 i LZP-së, nenin 58 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore evropiane.

E drejta e votës dhe liria e votimit sipas vlerësimit të Panelit, në rastin e vendeve të rezervuara nuk është identike me rastin e vendeve jo të rezervuara, pasi për vendet e rezervuara është me rëndësi lidhja objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar, sepse vetëm kështu sigurohet e drejta e përfaqësimit në kuptim të dispozitave të LZP-së, dhe në frymën e dispozitave dhe standardeve kushtetuese.

Vendet e rezervuara janë garanci kushtetuese, të cilat Republika e Kosovës i ka marr, me të vetmin qëllim për trajtimin e avancuar të të drejtave të pakicave në kuadër të institucioneve shtetërore.

Se ka pasur vota të orkestruara për subjekte të caktuara e të cilat vota janë fituar nga votues të cilët janë të komunitetit tjetër në krahasim me komunitetin e subjektit për të cilin ka votuar, kjo vërtetohet nga numri i banorëve në krahasim me numrin e votave të marra, ndërsa numri i banorëve pasqyrohet përmes të dhënave të marra nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës të vitit 2011, por edhe raporteve kredibile të OSBE-së dhe Librat e Votuesve.

Po ashtu, në raport me pakicat ekzistojnë standarde ndërkombëtare sipas të cilave shtetet përkatëse duhet të themelojnë praktika apo mekanizma të atillë, që u mundësojnë pjesëtareve të pakicave votim të lirë, krijimin të subjekteve të tyre si dhe parandalimin e çdo lloj diskriminimi për të zgjedh dhe për tu zgjedhur.

Nga raporti i OSBE-së, i vitit 2018 (i cili raport merret i besueshëm, për shkak se është organizatë kredibile, dhe ka qëndrim neutral ndaj të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës) numri i banorëve të komunitetit Rom në Komunën e Leposaviqit është 12 banorë, ndërsa nga Lista Përfundimtare e Votuesve, të Verifikuar nga PZAP-ja, për VV në këtë Komunë rezultojnë të jetë 1 votues potencial nga komuniteti Rom, ndërsa në këtë komunë kanë votuar 234 votues, për subjektin politik Romani Iniciativa, që rezultojnë se kanë votuar banorë të një komuniteti tjetër jo nga komuniteti rom, në Vendvotimet: 1201B/01R, 1201B/02R, 1201B/03D, 1201X/01R, 1202B/01R, 1202B/02R, 1202B/03D, 1205B/01R, 1205B/02R, 1205B/03D, ndërsa numri i votave për subjektin politik Romani Iniciativa, në këtë Komunë është në disproporcion të shumëfishtë me numrin e banorëve.

Nga ky raport (Raporti i OSBE-së), numri i banorëve të komunitetit Rom në Komunën e Novobërdës është 63 banorë, ndërsa nga Lista Përfundimtare e Votuesve, të Verifikuar nga PZAP, për VV në këtë Komunë rezultojnë të mos jetë asnjë votues potencial nga komuniteti Rom, ndërsa në këtë komunë kanë votuar 209 votues, për subjektin politik Romani Iniciativa, që rezultojnë se kanë votuar banorë të një komuniteti tjetër jo nga komuniteti rom, në Vendvotimet: 1403D/01D, 1404D/01D, 1406D/01D, 1410D/01D, 1412D/01R, 1412D/02D, 1413D/01D, 1414D/01D, 1415D/03D, 1417D/01D, 1418D/01D, ndërsa numri i votave për subjektin politik Romani Iniciativa, në këtë Komunë, janë në tërësi vota të dhëna nga një komunitet tjetër.

Nga ky raport (Raporti i OSBE-së), nuk ka banorë të komunitetit Rom në Komunën e Ranillugut, po ashtu as nga Lista Përfundimtare e Votuesve, të Verifikuar nga PZAP, për VV në këtë Komunë, nuk ka asnjë votues potencial nga komuniteti Rom, ndërsa në këtë komunë kanë votuar 159 votues, për subjektin politik Romani Iniciativa, që rezultojnë se kanë votuar banorë të një komuniteti tjetër jo nga komuniteti Rom pasi që nuk ekziston asnjë banorë në këtë komunë i komunitetit Rom, në Vendvotimet: 3501D/01R, 3501D/02D, 3502D/02D, 3504D/01R, 3504D/02D, 3505D/01D, 3506D/01D, 3507D/01D, ndërsa numri i votave për subjektin politik Romani Iniciativa në këtë Komunë, janë në tërësi vota të dhëna nga një komunitet tjetër.

Nga ky raport (Raporti i OSBE-së), nuk ka banorë të komunitetit Rom në Komunën e Parteshit, po ashtu as nga Lista Përfundimtare e Votuesve, të Verifikuar nga PZAP, për VV në këtë Komunë, nuk ka asnjë votues potencial nga komuniteti Rom, ndërsa në këtë komunë kanë votuar 88 votues, për subjektin politik Romani Iniciativa, që rezultojnë se kanë votuar banorë të një komuniteti tjetër jo nga komuniteti Rom, pasi që nuk ekziston asnjë banorë në këtë komunë i komunitetit Rom, në Vendvotimet: 3601D/01R, 3601D/02D, 3602D/01R, 3602D/02D, 3603D/01R, 3603D/02R, 3603D/03D, ndërsa numri i votave për subjektin politik Romani Iniciativa, në këtë Komunë, janë në tërësi vota të dhëna nga një komunitet tjetër.

Nga ky raport (Raporti i OSBE-së), janë 9 banorë të komunitetit Rom në Komunën e Klllokot, nga Lista Përfundimtare e Votuesve, të Verifikuar nga PZAP, për VV në këtë Komunë, nuk ka asnjë votues potencial nga komuniteti Rom, ndërsa në këtë komunë kanë votuar 147 votues, për subjektin politik Romani Iniciativa, që rezultojnë se kanë votuar banorë të një komuniteti tjetër jo nga komuniteti Rom, që rezultojnë se kanë votuar banorë të një komuniteti tjetër jo nga komuniteti rom, në Vendvotimet: 3701D/01R, 3701D/02D, 3702D/01D, 3703D/01R, 3703D/02D, ndërsa numri i votave për subjektin politik Romani Iniciativa, në

këtë Komunë, janë në dispropocion te shumëfishtë me votat të dhëna nga një komunitet tjetër.

Tendenca për krijimin e praktikave të tilla të votimit masiv nga pjesëtarët e njërit komunitet për subjektin e komunitetit tjetër, paraqet praktikë të rrezikshme e cila në të ardhmen do të mund të shfrytëzohej nga komuniteti shumicë, për t'ia pamundësuar të drejtën e përfaqësimit në mënyrë objektive komuniteteve tjera pakicë.

Anulimi i votave për subjektin e cekur si në dispozitiv të këtij vendimi, ka për qëllim ruajtjen dhe garantimin e të drejtës së përfaqësimit, në raport me përqindjen e popullsisë nga ky komunitet, sikurse garantohet me ligj dhe Kushtetutë e Republikës së Kosovës.

Paneli, vendosi si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, në 4 (katër) komunat e lartcekura duke anuluar votat e fituara nga subjekti politik Romani Iniciativa, për arsye se votat e fituara janë në disproporcion dhe nuk korrespondojnë me numrin e banorëve të komunitetit rom si dhe për arsyet e cekura si më lartë.

Në raport me pjesën refuzuese pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse kërkesën sepse anulimi i të gjitha votave në vendvotimet e cekura si në pikën e III-të dispozitivit të këtij vendimi, do të përbënte anulim të pa bazuar të fletëvotimeve të vlefshme, pasi jo të gjitha votat për komunitetin romë kanë qenë të orkestruara.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafët 2 dhe 3, neni 119 paragrafi 5, neni 120 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.736/2021 më datë 07.03.2021

Kryesuesi i Panelit
Rrustem Thaqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa, brenda afatit 24 orë nga dita e pranimiit, në Gjykatën Supreme.